INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES

TERMAT E REFERENCËS

Rindërtim Portali, Mirëmbajtje dhe Menaxhim, Data entry

Projekti "Mbi viktimat e kufirit: Informim e sensibilizim për viktimat e vrasjeve dhe zhdukjeve gjatë arratisjeve në kufij gjatë viteve 1988-1991"

Instituti i Studimeve Politike (ISP) kërkon të kontraktojë **një subjekt për Rindërtimin e një Portali, Mirëmbajtje dhe Menaxhim, Data entry,** pjesë e projektit *"Mbi viktimat e kufirit: Informim e sensibilizim për viktimat e vrasjeve dhe zhdukjeve gjatë arratisjeve në kufij gjatë viteve 1988-1991*" me mbështetje të International Commission on Missing Persons (ICMP), përmes grantit të financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri.

Pozicioni / Shërbim	Mirëmbajtje portali dhe zhvillim, data entry
Titulli i Projektit	"Mbi viktimat e kufirit: Informim e sensibilizim për viktimat e vrasjeve dhe zhdukjeve gjatë arratisjeve në kufij gjatë viteve 1988-1991"
"Mbështetur:	International Commission on Missing Persons (ICMP), përmes grantit të financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri
Lloji i Kontratës :	Kontratë shërbimi
Periudha e kontratës	1 vit

ISP me mbështetjen e International Commission on Missing Persons (ICMP), përmes grantit të financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri do të implementojë projektin"Mbi viktimat e kufirit: Informim e sensibilizim për viktimat e vrasjeve dhe zhdukjeve gjatë arratisjeve në kufij gjatë viteve 1988-1991".

Rreth ISP-së

ISP është organizatë joqeveritare në fushën e studimeve politike në Shqipëri. Fokusi i saj kryesor është monitorimi i proceseve politike të tranzicionit, aktivitetit të institucioneve politike dhe kushtetuese, edukimi publik përmes parimeve të transparencës, pjesëmarrjes, përfaqësimit dhe njohjes së koncepteve thelbësore për demokraci funksionale.

Rreth projektit

Informimi dhe sensibilizimi i institucioneve dhe publikut për të promovuar zbardhjen e plotë të rasteve që kanë të bëjnë me persona të vrarë ose të zhdukur, duke inkurajuar kërkimin e varreve të viktimave pa varre ose të zhdukur, dhe duke nxitur një qasje institucionale për vendosjen e drejtësisë për to, "rehabilitimin" nëpërmjet kujtimi dhe nderimi i tyre.

Qëllimi i shërbimit

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, ISP hap thirrjen për angazhimin e një Subjekti për mirëmbajtjen e një ueb-site përfshirë rindërtimin, update-in dhe mirëmbajtjen. Subjekti duhet të jetë i/e gatshëm të ofrojë suportin për mirëmbajtjen dhe funksionimin portalin www.muzeuimemories.info , rindërtimin e site-it ose ndryshimin e seksioneve te webit duke e përshtatur atë me kërkesat dhe nevojat e projektit të ri.

Subjekti, bazuar në kërkesat dhe të dhënat e vendosura në dispozicion nga stafi zbatues i ISP, do të përmbushë shërbimet e mëposhtme:

Detyrimet dhe përgjegjësitë për zhvillimin e Web dhe mirëmbajtjen:

- Të krijojë seksione te reja, rindërtojë, mirëmbajë dhe përditësojë portalin në funksion të projektit dhe backup të vazhdueshëm të të dhënave;

- Të mbështesë të gjithë ciklin jetësor të ueb-it në internet për gjithë kohëzgjatjen e projektit (duke përfshirë konceptin, testimin, publikimin, ngarkimin e materialeve, ofrimin e mbështetjes teknike);

- Të lidhet rregullisht me koordinatorin e projektit/skuadrën e projektit dhe marr pjesë në takime kur është e nevojshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit. Materialet përkatëse do të përgatiten dhe sigurohen nga Ekipi i Projektit;

- Të sigurohet që faqja të përmbushë kërkesat ligjore dhe standardet, siç janë ato për mbrojtjen e të dhënave personale;

- Përdorimi i mjeteve analitike për të monitoruar dhe përmirësuar performancën e faqes.

- Të mundësojë facilitimin e përdoruesve të ueb- site;

- Të sigurohet që faqja të funksionojnë pa probleme dhe të jetë e optimizuar për shpejtësinë dhe performancën e duhur;

- Të adresojë drejt subjektit IT të kontraktuar, duke vënë në dijeni paralelisht stafin përgjegjës për koordinimin e projektit, çdo keq-funksionim apo crash teknologjik që mund të pësojë ueb-site.

ISP inkurajon aplikimet nga kandidatë, të cilët janë të interesuar për t'u angazhuar në këtë proces dhe plotësojnë këto kritere:

Kriteter për subjektet:

Subjektet janë të lutur të japin ofertat e tyre për të cilat do të ketë procedurë vlerësimi dhe do të lidhet kontratë me ofruesin/it më të mirë. Ato duhet të kenë eksperiencë në fushën e Krijimit të faqeve të webit, konceptimit të formatit, përgatitjes, mirëmbajtjes etj.

Dokumentet e Aplikimit për subjektet:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar duhet të dorëzojnë:

1. Dokument regjistrimi ne QKB (Nipt i biznesit ose ekstakt regjistrimi);
2. Ofertuesi duhet të këtë mbi 10 vite operimi në territorin e Shqipërisë;
3. Punë të ngjashme (Referenca Link);
4. Ofertë Financiare e nënshkruar në Euro (përfshirë TVSH-në **).**

Kostot dhe Pagesat

Mënyra e pagesës përcaktohet në Kontratën e Shërbimit. Pagesa do të kryet pas paraqitjes së materialeve të realizuara nga Subjekti/Eksperti për punën e kryer.

Aplikimet duhet të dërgohen jo më vonë se data 15/10/2024 ora 23:59.

- në formë elektronike në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com, ose contactaips@isp.com.al

me postë në adresën: Rr. "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë ose dorazi me zarf të mbyllur pranë zyrave të ISP me titullin e projektit sipër "Rindërtim Portali, Mirëmbajtje dhe Menaxhim, Data entry".

Vetëm fituesi do të njoftohet.

Me konsideratë,

Instituti i Studimeve Politike